



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0381

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) NIL ARCHITECTS SH.P.K., kundër Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit, Njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tendës të Agjencia Qendrore të Prokurimit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Hartimi i projekteve dhe mbikqyrja e punimeve për nevojat e APRK-së me numër të prokurimit 201/26300-26-3812-2-2-1, me 25/06/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE NIL ARCHITECTS SH.P.K., me nr. 2026/0381, e datës 12/06/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Hartimi i projekteve dhe mbikqyrja e punimeve për nevojat e APRK-së me numër të prokurimit 201/26300-26-3812-2-2-1.
2. Korrigjohet , Njoftimi për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit sipas dispozitivit I të këtij vendimi, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.05.2026 Agjencia Qendrore e Prokurimit, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për kontratë B05, për aktivitetin e prokurimit Hartimi i projekteve dhe mbikqyrja e punimeve për nevojat e APRK-së me numër të prokurimit

201/26300-26-3812-2-2-1.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 15,000.00 €.

Me 04.06.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 05.06.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12.06.2026, OE NIL ARCHITECTS SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0381, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, kundër njoftimit për kontratë-kritereve.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues NIL ARCHITECTS SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

PRETENDIMI 1 – Kërkesa për certifikim FIDIC për Menaxherin e Projektit dhe Inxhinierin Konstruktiv

Në dosjen e tenderit është kërkuar që 1.1 Menaxheri i Projektit-Inxhinieri i diplomuar i Arkitekturës dhe 1.2 Inxhinieri i diplomuar Konstruktiv të posedojnë certifikim FIDIC. Konsiderojmë se kjo kërkesë është kufizuese, jo proporcionale dhe në kundërshtim me nenin 1, nenin 7 dhe nenin 51 të Ligjit për Prokurimin Publik, për arsyt si në vijim: Legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës nuk përcakton obligim ligjor që Menaxheri i Projektit apo Inxhinieri Konstruktiv të posedojnë certifikim FIDIC për realizimin e kontratave publike. Përdorimi i standardeve apo kontratave FIDIC nuk aplikohet në Kosovë.

Kjo kërkesë kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që posedojnë staf profesional me përvojë dhe kualifikime adekuate, por që nuk posedojnë certifikim specifik FIDIC. Kërkesa nuk është proporcionale me objektin e kontratës dhe tejkalon nevojat reale të Autoritetit Kontraktues, duke cenuar konkurrencën e lirë dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë. Gjithashtu, kjo kërkesë bie ndesh me Nenin 1 të LPP-së, i cili përcakton qëllimin e ligjit për sigurimin e përdorimit efikas të fondeve publike, zhvillimin e konkurrencës së hapur dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë. Për këto arsye, kërkojmë që kjo kërkesë të largohet nga dosja e tenderit.

PRETENDIMI 2 – Kërkesa 1.3 Inxhinieri i diplomuar i Arkitekturës të posedojë certifikim për auditim të energjisë në ndërtesa

Në dosjen e tenderit është kërkuar që 1.3 Inxhinieri i diplomuar i Arkitekturës të jetë i certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa.

Konsiderojmë se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 7, nenin 28 dhe nenin 51 të Ligjit për Prokurimin Publik, për arsyt si në vijim:

Certifikimi për auditim të energjisë në ndërtesa paraqet kualifikim profesional që mund të posedohen nga profesionistë të ndryshëm teknikë dhe nuk është e domosdoshme të kufizohet ekskluzivisht te pozita e Arkitektit. Duke e specifikuar vetëm Arkitektin si bartës të kësaj certifikate, Autoriteti Kontraktues

kufizon pa nevojë konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që mund ta mbulojnë këtë kërkesë përmes stafit tjetër profesional.

Kërkesa nuk është proporcionale me objektin e kontratës, pasi që qëllimi i AK-së mund të arrihet edhe nëse certifikata posedohen nga cilido anëtar i stafit profesional të kërkuar. Specifikimi i tillë krijon kufizim të konkurrencës dhe bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit në procedurat e prokurimit publik. Për këto arsye, kërkojmë që kjo kërkesë të modifikohet në mënyrë që certifikimi për auditim të energjisë në ndërtesa të mund të posedohet nga njëri prej profesionistëve të stafit teknik të kërkuar dhe jo domosdoshmërisht nga një inxhinier i specifikuar.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Përgjigjet e AQP-së lidhur me pretendimet e OE: NIL ARCHITECTS SH.P.K.

Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues vendos ta refuzojë kërkesën si të papabazuar për arsyt në vijim:

Lidhur me pretendimin 1 – Certifikimi FIDIC

Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa që Menaxheri i Projektit dhe Inxhinieri Konstruktiv të posedojnë certifikim FIDIC është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin dhe kërkesat e kontratës.

Kjo kërkesë nuk është vendosur si kusht diskriminues, por si mjet për të siguruar që stafi kyç të ketë njohuri profesionale mbi menaxhimin e kontratave, administrimin e punimeve, procedurat e pretendimeve, kontrollin e afateve dhe menaxhimin e rreziqeve, të cilat janë elemente të rëndësishme për realizimin e suksesshëm të projektit.

Ligji për Prokurimin Publik i lejon Autoritetit Kontraktues të përcaktojë kërkesa profesionale dhe teknike që janë proporcionale me objektin e kontratës dhe të nevojshme për realizimin e saj. Fakti që certifikimi FIDIC nuk është i detyrueshëm me legjislacion nuk e pengon Autoritetin Kontraktues që ta kërkojë atë kur vlerësohet se është i nevojshëm për ekzekutimin e kontratës.

Për më tepër, certifikimi FIDIC është i qasshëm për të gjithë operatorët ekonomikë dhe nuk favorizon ndonjë operator të caktuar ekonomik.

Lidhur me pretendimin 2 – Certifikimi për auditim të energjisë në ndërtesa

Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa që Inxhinieri i diplomuar i Arkitekturës të posedojë certifikim për auditim të energjisë në ndërtesa është e justifikuar nga natyra dhe objektivat e projektit.

Duke pasur parasysh se aspektet e performancës energjetike, efikasitetit energjetik dhe vlerësimit të ndërtesave përbëjnë pjesë të rëndësishme të objektit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se posedimi i këtij certifikimi nga eksperti i kërkuar garanton nivelin e nevojshëm të ekspertizës profesionale.

Kërkesa nuk është vendosur për të kufizuar konkurrencën, por për të siguruar cilësi dhe kompetencë profesionale në realizimin e kontratës. Autoriteti Kontraktues konsideron se kërkesa është proporcionale me objektin e kontratës dhe nuk bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës.

Vendimi

Bazuar në arsyet e mësipërme, Autoriteti Kontraktues konstaton se kërkesat e kontestuara janë të lidhura me objektin e kontratës, janë proporcionale dhe të nevojshme për realizimin e saj. Rrjedhimisht, kërkesa për rishqyrtim refuzohet si e pabazuar dhe dosja e tenderit mbetet e pandryshuar.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 16.06.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0381, ndërsa me datë 19.06.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0381, me rekomandimet si në vijim: Duke pasë parasyshë sqarimet dhe konstatimet për secilin pretendim, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues të aprovoj Ankesën e Oe dhe të obligoj AK që të rishyrtoj , përkatësisht heq kriteret e kontestuara nga OE ankues.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar pjesërisht rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE NIL ARCHITECTS SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0381 ka vlerësuar si në vijim:

PRETENDIMI -1 i Operatorit Ekonomik:

OE pretendon se AK në dosjesn e tenderit ka kërkuar certifikimin FIDIC për Menaxherin e Projektit dhe Inxhinierin Konstruktiv, dhe konsideron se

kjo kërkesë është kufizuese, jo proporcionale dhe në kundërshtim me nenin 1, nenin 7 dhe nenin 51 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Përgjigje e AK në pretendimin e parë:

Konstatimet e Ekspertit Shqyrtues për pretendimin e parë:

Përmes verifikimeve në internet, vleresojme se kërkesa për certifikim të Menaxherit të Projektit-arkitektit, dhe inxhinierit konstruktiv me certifikatë FIDIC për këtë kontratë është i panevojshëm, pasi që rasti nuk ka të bëjë me kontarta specifike për ndërtim të projekteve e mëdha të ndërtimit dhe infrastrukturës, në të cilat zakonisht këkohet ky certifikim.

KONSTATIM: Pretendimi i OE-së është i bazuar, rekomandohet rishqyrtimi ose heqja e këtij kriteri.

PRETENDIMI -2 i Operatorit Ekonomik:

Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit ka kërkuar që Inxhinieri i diplomuar i Arkitekturës të jetë i certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa, dhe konsideron se kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 7, nenin 28 dhe nenin 51 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Përgjigje e AK në pretendimin e dytë:

Konstatimet e Ekspertit Shqyrtues për pretendimin e dytë:

Inxhinieri i Arkitekures duke qenë Menaxher i Projektit mund të angazhoj staf adekuat sipas nevojës, pra edhe staf të certifikuar për auditim të energjisë në ndërtesa. Në këtë frymë është edhe përshkrimi në Specifikacionit Teknik të dosjes së tenderit te paragrafi: Mbikëqyrja profesionale inxhinierike e punimeve për punët e kontraktuara!

KONSTATIM: Pretendimi i OE-së është i bazuar, rekomandohet rishqyrtimi ose heqja këtij kriteri.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Hartimi i projekteve dhe mbikqyrja e punimeve për nevojat e APRK-së me numër të prokurimit 201/26300-26-3812-2-2-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrirat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të gjitha fakteve dhe argumenteve ka arritur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Si rrjedhojë, bazuar në nenet 1 dhe 7 të LPP-së, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, dhe ka vendosur që për aktivitetin e prokurimit me titull “Hartimi i projekteve dhe mbikëqyrja e punimeve për nevojat e APRK-së”, me numër të prokurimit 201/26300-26-3812-2-2-1, të obligohet Autoriteti Kontraktues që të bëjë korrigjimin e procedures në përputhje të plotë me konstatimet e raportit të ekspertit shqyrtues dhe të zgjasë afatin për dorëzimin e ofertave sipas dispozitave ligjore në fuqi të LPP-së.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Kompetente në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Agjencia Qendrore e Prokruimit , Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- **OE - NIL ARCHITECTS SH.P.K., NIL ARCHITECTS SH.P.K.**
- **Arkivës së OSHP-së:**